



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 56 Dt. 11.02.2023
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Në bazë të Rregullores për Punën e Komisionit Arbitrar të FBK-së, Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023), si dhe në bazë të Ankesës së KB Trepça të datës 01.02.2023, Komisioni Arbitrar i FBK-së, me datë 11.02.2023 merr këtë:

VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME kërkesa e KB Trepça e datës 01.02.2023;
- II. REFUZOHET ankesa e KB Trepça e datës 01.02.2023;
- III. MBETET NË FUQI vendimi i Komisionit të Garave sipas Informatorit nr.20/2023.

ARSYETIM

Me datë 07.02.2023, Komisioni Arbitrar, përmes postës elektronike, ka pranuar Ankesën e KB Trepça të datës 01.02.2023 (tash e tutje: 'Ankesa'). Kjo e fundit ka të bëjë me vendimin e Komisionit të Garave të FBK-së në Informatorin nr.20/2023 (tash e tutje: 'Vendimi'), lidhur me incidentin në ndeshjen e datës 28.01.2023 mes KB Trepça dhe KB Golden Eagle Ylli (xhiro XX e Prince Caffè Superligës 2022-2023).

Në këtë kuadër, Komisioni Arbitrar ka mbajtur takim më 11.02.2023, dhe ka trajtuar Ankesën e KB Trepça, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës. Në takim kanë qenë prezent: Korab Sejdiu (Kryetar i Komisionit Arbitrar), Lulzim Fushtica (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Fidan Hamiti (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së dhe Këshilltarja Ligjore për Sport e FBK-së.

Sipas kuptimit të Komisionit Arbitrar, KB Trepça në Ankesë sfidon pikën 2 të Vendimit, sipas së cilës këtij klubi i'u shqiptua dënimi me një ndeshje pa shikues, konform nenit 49.17 të Propozicioneve të Garave (PG) për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023).

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Biloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Komisioni Arbitrar gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsytet në vijim.

Nga video e transmetimit të ndeshjes, është më se e qartë se përkundër obligimit që ka si organizator i ndeshjes, KB Trepça ka dështuar të sigurojë që prej fillimit të ndeshjes e deri pas përfundimit të saj, përveç akterëve të ndeshjes, askush të mos jetë i pranishëm në fushën e lojës (konform nenit 28.5 të Propozicioneve të Garave). Edhe pse asnjëra nga video inçizimet nuk ofron pamje që konfirmojnë apo refuzojnë supozimin për tentim të sulmit fizik ndaj gjyqtarit Uglari, KB Trepça nuk ka ofruar prova që kundërshtojnë deklaratat e personave të përfshirë.

Në anën tjetër, Komisioni Arbitrar e ka parasysh se në këtë fazë të garave, nuk është e drejtë që tifozët e mirësjellshëm në tribuna të dënohen për shkak të veprimeve të individëve ose mos-përmbushjes së detyrimeve nga KB Trepça. Poashtu, Komisioni vlerëson faktin se KB Trepça në vazhdimësi ka treguar gatishmëri për luftimin dhe parandalimin e dukurive negative në sport, mirëpo kjo nuk hedh poshtë faktin se fusha e lojës u cenua nga persona jozyrtarë dhe se treshja e gjyqtarëve u desh të shoqërohej drejt zhveshtores nga Policia e Kosovës.

Për më tepër, Komisioni Arbitrar adresoi pretendimet e KB Trepça se Komisioni i Garave reflekton si tendencioz dhe përdor standarde të dyfishta. Ky pretendim i KB Trepça nuk qëndron sepse rastet e cituara nga klubi dallojnë nga rasti aktual në aspekt faktik, dhe rrjedhimisht, aplikohen edhe dispozita të ndryshme të Propozicioneve të Garave. Pra, sa i përket dy shembujve të ofruar nga klubi, Komisioni konstatoi se dallimet faktike mes rasteve janë ato që kanë rezultuar në dënime të ndryshme prej atij ndërmarr ndaj KB Trepça, dhe se këto raste nuk syjgjerjnë lëkundje në objektivitetin e Komisionit të Garave.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Komisioni Arbitrar vlerëson se, në mungesë të provave që konstatojnë ndryshe, Komisioni i Garave me të drejtë është bazuar në Nenin 49.17 të PG, me të cilin dënohet tentimi i sulmit fizik ndaj gjyqtarëve nga persona jozyrtarë. Dënimi i shqiptuar, në mendim të Komisionit Arbitrar, përçon qartë tek të gjitha klubet, se sigurimi i ambientit të qetë dhe të sigurt nga ekipet vendase është jetik për zhvillimin e ndeshjeve, dhe se dështimi për të bërë një gjë të tillë bartë pasojat përkatëse.

Rrjedhimisht, Komisioni Arbitrar duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Arbitrar:

Fidan Hamiti
Anëtar

Korab Sejdiu
Kryetar

Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 11 Shkurt 2023

Vendimi i dërgohet:

- KB Trepça
- Komisionit të Garave
- Anëtarëve të Komisionit Arbitrar
- Arkivit të FBK-së



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

